

## Rikthim i kostove nga sëmundja nëpërmjet pagesave shtesë

### 1. Kushtet paraprake pretenduese

Pretendim për rikthimin e kostove të pambuluara nga sëmundja kanë persona, të cilët në të njëjtën periudhë kohore kanë pretendim për një pagesë mujore shtesë. Iu refuzuan një personi pagesat shtesë për shkak të një teprice të ardhurash, mund të ripaguhen kostot e vërtetuara nga sëmundja pas zbritjes së tepricës nga të ardhurat.

Të pagueshme janë vetëm kostot që janë shkaktuar në Zvicër. Kostot e shkaktuara jashtë shtetit mund të merren parasysh si përjashtim, nëse ato ishin të nevojshme gjatë një qëndrimi jashtë shtetit.

### 2. Paraqitja / Afati

Që të mund të bëhet një shpërblim për shpenzimet, duhet të paraqiten dokumentet e plota në seksionin për të moshuar dhe sigurime të qytetit Bernë, në mënyrë ideale çdo tre muaj.

Adresa: Alters- und Versicherungsamt, AHV-Zweigstelle, Bundesgasse 33, 3011 Bern

Ripagimi i kostove duhet të kërkohet brenda 15 muajsh që prej faturimit ose llogaritjes së arkës së sigurimit shëndetësor.

### 3. Koste të pagueshme nga sëmundja dhe aftësitë e kufizuara

- **Pjesëmarrje në kosto të arkës së sigurimit shëndetësor nga sigurimi i detyrueshëm për përkujdesje në rast sëmundjeje** (obligatorische Krankenpflegeversicherung KVG)  
Franshizë [pjesëmarrje në shpenzimet] dhe 10% kontribut vetjak deri në shumën vjetore prej CHF 1'000 / fëmijë CHF 350 franga me anë të llogaritjeve të veçanta, të plota të shërbimeve nga ana e arkës shëndetësore.

- **Trajtime të dhëmbëve**

Kostot për trajtimin e dhëmbëve mund të merren parasysh vetëm nëse ato i përkasin një zbatimi ekonomik dhe të përshtatshëm. Sqarime përkatëse pasojnë nëpërmjet të arkës kantonale të kompensimit mbështetur mbi faturat e paraqitura ose mbi preventivet.

Nëse kostot e trajtimit të planifikuar të dhëmbëve pritet të jenë më të larta se 1500 CHF, duhet të dorëzohet para trajtimit një preventiv me formularin për dhëmbët (gjendja e dhëmbëve). Në faturat dhe në preventivet duhet të jenë shënuar gjithmonë numrat e dhëmbëve. Në rast të dorëzimit për herë të parë të një fature të dentistit nevojitet një formular për dhëmbët.

Edhe në rast të rregullimeve me mjekim të rrënjëve, me kurorë, implantate, zburime, mbushje të kupolës, ura, kapa kunji rrënje rekomandohet që të dorëzoni paraprakisht për shqyrtim një preventiv me formularin e dhëmbëve për shqyrtim.

Përcaktime të mëtejshme për mënyrën e faturimit mund të shihen në fletëshpjegimin për dentistë dhe dentiste, që mund të merret në filialin për të moshuar dhe sigurime (AHV-Zweigstelle) ose që shihet në faqen e internetit [www.akbern.ch](http://www.akbern.ch).

- **Transporte për në vendin më të afërt të trajtimit mjekësor**  
Për ripagimin e kostove të transportit për në vendin tjetër të trajtimit mjekësor që ndodhet më afër duhet që kostot të bashkërenditen në një formular. Një shpërblim i kostove për transportin për taksi/betaksi/makina private është vetëm atëherë i mundshëm, nëse me anë të certifikatës së mjekut do të vërtetohet, që mjetet e qarkullimit publik nuk mund të përdoren. Formularët dhe fletëshpjegimi mund të merren në filialin për të moshuar dhe sigurime.
- **Kujdesi dhe përkujdesja nëpërmjet të pjesëtarëve të familjes**  
Për kujdesin bazë të nevojshëm të bërë nga pjesëtarët e familjes si kujdesi për gojën dhe trupin, çuarje në shtrat, pozicionimi, mobilizimi etj. shpërblehet me 25 CHF në orë dhe me së shumti me 9'600 franga në vit, nëse pjesëtarja e familjes ose pjesëtari i familjes nuk janë të lidhur në llogaritjet EL (pagesat shtesë). Masat e përkujdesjes të njohura si kosto për sëmundje nga EL (shpenzimet e kohës për të shkuarit në kontroll, shëtitje etj.) shpërblehen me një çmim ore prej 25 CHF dhe së shumti në vëllimin e humbjeve të pagës. Duhet të jetë e pranishme dëshmia e humbjeve faktike të pagës. Nëpërmjet kësaj krijohen po ashtu detyrimet për llogaritje të kontributeve të detyruar të sigurimeve shoqërore (AHV/IV etj.) dhe detyrimi përkatës për taksë.  
Formularët e duhur për sqarimin e nevojës gjenden në seksionin për të moshuar dhe sigurime ose në faqen e internetit [www.akbern.ch](http://www.akbern.ch). Përveç kësaj nevojitet një certifikatë mjeku me dëshmitë e nevojës për ndihmën dhe përkujdesjen në shtëpi.
- **Ndihmë në ekonominë shtëpiake nga institucione dhe persona, të cilët nuk jetojnë në të njëjtën ekonomi shtëpiake**
- Ndihmë në ekonominë shtëpiake nga shërbimet 'Spitex' pas paraqitjes së një sqarimi të nevojës dhe të një certifikate mjeku.  
Nëse pjesëtarët e familjes ose persona të tretë kryejnë punët e nevojshme të ekonomisë shtëpiake, mund të shpërblehen kostot e vërtetuara të vëna në faturë deri në CHF 4'800 në vit (më së shumti CHF 25 në orë). Edhe këtu nevojitet paraqitja e një certifikate mjeku që vërteton nevojshmërinë e një ndihme në ekonominë shtëpiake.  
Përveç kësaj nuk lejohet që personi zbatues të jetojë në të njëjtën ekonomi shtëpiake.
- **Mjete ndihmëse**
- Kostot për mjete ndihmëse, të cilat financohen pjesërisht nga AHV (karrige me rrota, këpucë ortopedike me masë dhe në seri, epiteza fytyre, paruke, aparate dëgjimi, aparate ndihme për të folur, syze lupë) dhe syze katarakti.
- **Qëndrim lehtësimi në një strehë ose në një spital**
- **Kura banje dhe çlodhjeje të urdhëruara nga mjeku**
- **Kujdesi dhe përkujdesja në qendra të kujdesisë ditore.**
- **Pjesëmarrja e pacientit në kujdesinë 'Spitex'**
- **Dietë e nevojshme mjekësore në shtëpi**
- Kosto të vërtetuara për një dietë të nevojshme mjekësore në shtëpi (përrjashtuar ushqime në rast të diabetit).

#### 4. Shuma më e lartë për shpërblimin

Për kosto të vërtetuara nga sëmundjet dhe aftësitë e kufizuara mund të shpërblehen për vit kalendarik si shtesë krahas pagesave vjetore shtesë së shumti kontributet e mëposhtme:

- Persona të që rrinë me vete CHF 25'000
- Çifte bashkëshortore CHF 50'000
- Banorë strehësh CHF 6'000